

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**K A B I N E T I**

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë

Tel. 226307 Fax. 232002

Prot.....

**R R E G U L L O R E**  
**P Ë R**  
**PRANIMET E REJA PA KONKURS NË SHKOLLAT E MESME**  
**SOCIAL-KULTURORE, TEKNIKE DHE NË SHKOLLAT PROFESIONALE**

1. Pranimet e reja në shkollat e mesme pedagogjike, në shkollat profesionale dhe në shkollat teknike, të cilat janë pa konkurs, bëhen sipas një **plani** të hartuar nga MASH për çdo DAR ose ZA.
2. Ky plan hartohet nga DZHK në MASH dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës apo personi i autorizuar prej tij.
3. Në këtë plan, MASH i përcakton çdo DAR ose ZA numrin e nxënësve që do të dërgojë për studim, specialitetin dhe shkollën, ku këta nxënës do të studiojnë.
4. Në bazë të planit të dërguar nga MASH, DAR ose ZA, duke bashkëpunuar me bashkitë, komunat dhe qarkun, përcaktojnë listën emërore të nxënësve që do të ndjekin këto shkolla, sipas specialiteteve përkatëse. Ato duhet të bëjnë kujdes në zgjedhjen e kandidatave sa më cilësore.
5. Plani i pranimeve pa konkurs, i ardhur nga MASH, afishohet nga DAR ose ZA në fund të muajit korrik.
6. Plani i detajuar i pranimeve, i hartuar dhe miratuar nga DAR ose ZA, afishohet në fund të javës së parë të muajit gusht.
7. DAR ose ZA njofton drejtoritë e shkollave, ku ka plan, për nxënësit e planifikuar për studim.
8. **Regjistrimet** për nxënësit, në shkollat pa konkurim, do të bëhen individualisht. Ato fillojnë nga java e parë e muajit shtator dhe mbyllen në fund të javës së dytë të muajit shtator.
9. Brënda këtij afati kandidati paraqet në shkollën, ku do të regjistrohet, këto dokumenta:
  - a. Dëftesën e lirimit ose një kopje të saj të noterizuar.
  - b. Çertifikatën e lindjes me fotografi të vulosur.
  - c. Çertifikatën për gjendjen e tij mjeksore.
  - d. Vërtetimin nga DAR ose ZA përkatëse për planizimin e tij në degën apo specialitetetin, ku do të studiojë.
10. Për çdo keqkuptim, drejtoria e shkollës pritëse komunikon me DAR ose ZA nga vjen nxënësi. Kjo e fundit duhet të përgjigjet urgjentisht për problemet e diskutueshme.
11. Nxënësi i planifikuar dhe i regjistruar, **që nuk paraqitet** në shkollë me fillimin e vitit shkollor, për arsye të veçanta, qoftë dhe të justifikuara, për të ruajtur vendin duhet të njoftojë drejtorinë e shkollës brenda javës së parë të vitit shkollor.
12. Në qoftë se një nxënës i planifikuar apo i regjistruar nuk paraqitet në shkollë javën e parë të mësimeve dhe nuk e justifikon mungesën, atëherë ai e humbet të drejtën për të vazhduar shkollën dhe e fiton atë nxënësi i rradhës në listë e kërkesave të hartuar në DAR ose ZA, me nxënësi nga rrethi ku ndodhet shkolla.

Çdo rregull tjetër që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.  
Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**M I N I S T R I**